



Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
MISIONI NË KOSOVË

RAPORT

MBI

RAPORTET FINANCIARE VJETORE TË PARTIVE POLITIKE

PËR VITET 2002 DHE 2003

Departamenti i Zgjedhjeve
Zyra e Regjistrimit të Partive Politike

Maj 2004

PASQYRA E LËNDËS

1. PËRMBLEDHJE E SHKURTËR	2
2. HYRJE	3
3. VLERËSIM I PËRGJITHSHËM.....	4
4. BURIMET E INFORMIMIT.....	6
5. ANALIZË SIPAS PARTIVE POLITIKE.....	10
5.1. AAK – ALEANCA PËR ARDHMËRINË E KOSOVËS	10
5.2. BSDAK – PARTIA E AKCIONIT DEMOKRATIK TË BOSHNJAKËVE TË KOSOVËS.....	11
5.3. DSB – PARTIA BOSHNJAKE E KOSOVËS	11
5.4. GIG – INICIATIVA QYTETARE E GORËS.....	11
5.5. IRDK – INICIATIVA E RE DEMOKRATIKE E KOSOVËS	11
5.6. KDTP – PARTIA DEMOKRATIKE TURKE E KOSOVËS.....	12
5.7. KOS – PARTIA OBJEKTIVE E KOSOVËS	12
5.8. LDK – LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS	12
5.9. LKÇK – LËVIZJA KOMBËTARE PËR ÇLIRIMIN E KOSOVËS.....	13
5.10. LPK – LËVIZJA POPULLORE E KOSOVËS.....	13
5.11. PD – PARTIA E DREJTËSISË	13
5.12. PDAK – PARTIA DEMOKRATIKE E ASHKALIVE TË KOSOVËS.....	14
5.13. PDASHK – PARTIA DEMOKRATIKE ASHKALI SHQIPTARE E KOSOVËS.....	14
5.14. PDK – PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS	14
5.15. PGJK – PARTIA E TE GJELBERVE TE KOSOVES	15
5.16. PLK – PARTIA LIBERALE E KOSOVËS.....	16
5.17. PLSH – PARTIA LIBERALE SHQIPTARE	16
5.18. PND SH – PARTIA NACIONALE DEMOKRATIKE SHQIPTARE	16
5.19. PREBK – PARTIA ROME E BASHKUAR E KOSOVËS.....	16
5.20. PREK – PARTIE E RE E KOSOVËS.....	17
5.21. PRSH – PARTIA REPUBLIKANE SHQIPTARE	17
5.22. PSDK – PARTIA SOCIAL DEMOKRATE E KOSOVËS	17
5.23. PSHDK – PARTIA SHQIPTARE DEMOKRISTIANE E KOSOVËS	17
5.24. SDA – PARTIA E AKCIONIT DEMOKRATIK.....	18
5.25. UDGJ – UNIONI DEMOKRATIK I GJAKOVËS.....	18
5.26. UNIKOMB – PARTIA E UNITETIT KOMBËTAR SHQIPTAR.....	18
6. SHTOJCA A KUSHTET DHE PËRCAKTIMET	19
7. SHTOJCA B REGJISTRI I DONACIONEVE DHE I KONTRIBUTEVE MONETARE	20
8. SHTOJCA C-REGJISTRI I KONTRIBUTEVE NË NATYRË	28
9. SHTOJCA D REGJISTRI I PAGESAVE.....	31

RAPORT MBI RAPORTET FINANCIARE VJETORE TË PARTIVE POLITIKE PËR VITET 2002 DHE 2003

1. Përmbledhje e shkurtër

1. Bazuar në Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut nr. 2004/01, *Zbatimi i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/16 e ndryshuar, për regjistrimin dhe veprimtarinë e partive politike në Kosovë*, Zyra e Regjistrimit të Partive Politike mori detyrën për kryerjen e një revizioni të të gjitha partive politike të regjistruara. Nga partitë politike është kërkuar të publikojnë informatat financiare për veprimtarinë e tyre gjatë viteve 2002 dhe 2003. Informatat të cilat janë kërkuar që partitë t'i publikojnë, kanë qenë të kufizuara në donacionet monetare dhe kontributet në natyrë (në mall dhe shërbime), mbi 1,500 euro nga një burim i vetëm për secilin vit fiskal. Përveç kësaj, nga partitë është kërkuar të publikojnë informatat për pagesat që kalojnë mbi 10,000 euro nga një burim i vetëm për secilin nga këto dy vjet.

2. Shumica e partive i kanë dorëzuar informatat e tyre brenda afatit dhe mjaft korrekte. Pesë parti nuk i kanë dorëzuar raportet me kohë: tri nga këto parti janë konsideruar si jo funksionale dhe dy parti të tjera i kanë dorëzuar pas gjobave administrative dhe kohës shtesë, në përputhje me Urdhëresën Administrative.

3. Duke marrë parasysh se viti 2004 është vit i zgjedhjeve, është në interes të votuesve që partitë politike të tregojnë transparencë në çështjet financiare. Ky publikim gjithashtu ka qenë një tentim për t'i shtyrë partitë politike të kuptojnë dobitë e transparencës. Përpjekjet për të vendosur transparencën demokratike janë komponentë qenësore për arritjen e këtij qëllimi. Për këtë arsye OSBE-ja, së bashku me të tjerët, po punon me partitë politike për t'i inkurajuar që t'i ofrojnë publikut më shumë informata për aktivitetet e partive.

Zyra mendon që edhe pse partitë politike mund të kenë disa rezerva për publikimin e informatave financiare, në të ardhmen ato do t'i shohin dobitë duke fituar besimin e votuesve.

Vështirësia kryesore në të cilën ka hasur Zyra gjatë kryerjes së revizionit, kryesisht ka qenë e natyrës teknike. Shumica e partive kanë dorëzuar formularë të shkruar me dorë, të cilët, në shumë raste, ka qenë vështirë të lexohen. Përveç kësaj, në formularë shpesh kanë munguar informatat e plota. Është dashur që Zyra të kërkojë informata shtesë nga disa parti. Partive u është dhënë kopja e informatave të regjistruara në bazën e të dhënave për të verifikuar korrektësinë. Pasiqë informatat do të publikohen në internet, është shumë e rëndësishme që informatat të jenë sa më të sakta që të jetë e mundur.

Zyra rekomandon përmirësimet vijuese:

- Partitë politike do të duhet të bëhen më të vetëdijshme për rëndësinë e dhënies së informatave korrekte.
- Zyra do t'i ndihmojë partitë që të kenë softuerin kompjuterik, i cili do t'i bëjë proceset e raportimit më të lehta.
- Një sistem i kompjuterizuar do t'i mënjanojë vështirësitë teknike siç janë gabimet drejtshkrimore etj.

Hollësitë për secilën parti përshkruhen në pjesën e dytë të raportit.

2. HYRJE

Dispozitat e Urdhëresës së re Administrative të UNMIK-ut nr. 2004/01 (e cila zbaton Rregulloren UNMIK-ut nr. 2000/16 të ndryshuar, për regjistrimin dhe veprimtarinë e partive politike në Kosovë), i ka obliguar partitë politike të regjistruara në Kosovë të dorëzojnë raportet financiare vjetore për dy vitet fiskale 2002 dhe 2003. Qëllimi i raporteve është që t'i detyrojë partitë politike t'u përmbahen kërkesave të shoqërisë demokratike, duke e kuptuar vlerën thelbësore dhe rëndësinë e transparencës. Formularët e dhënë nga Zyra kanë mundësuar që partitë politike të publikojnë kontributet e tyre monetare ose në natyrë (në mall dhe shërbime) dhe pagesat duke identifikuar qëllimin e shfrytëzimit, nëse shumat e donacioneve, e kontributeve dhe pagesave në të holla gjatë vitit kanë kaluar limitin e kërkuar për raportim.

Urdhëresa Administrative nr. 2004/01

Urdhëresa Administrative 2004/01 (UA), Zbatimi i Rregullores së UNMIK-ut nr.2000/16 të ndryshuar, për regjistrimin dhe veprimtarinë e partive politike në Kosovë, kërkon nga partitë e regjistruara politike që të publikojnë donacionet monetare dhe kontributet në natyrë (në mall dhe shërbime) nga një burim i vetëm gjatë vitit. Nëse vlera e gjithmbarshme e donacionit monetar apo e një kontributi në natyrë (në mall dhe shërbime), nga një burim i vetëm, i kalon 1,500 euro, nga partia politike kërkohet të publikojë këtë informatë. Po kështu, partitë politike kanë qenë të obliguara të publikojnë pagesat monetare të një burimi të caktuar, nëse vlera e gjithmbarshme e të gjitha pagesave ndaj atij burimi gjatë vitit ka kaluar shumë prej 10,000 euro, duke e identifikuar qëllimin e shfrytëzimit. Raportet financiare vjetore për vitet 2002 dhe 2003 i përfshijnë të gjitha transaksionet financiare që janë bërë gjatë gjithë vitit fiskal, duke filluar nga 1 janari dhe duke mbaruar më 31 dhjetor. Sipas Pjesës 4 të Urdhëresës Administrative, Zyra ka kompetenca "të hetojë dhe verifikojë cilindo raport financiar vjetor të dorëzuar nga partitë politike duke përfshirë të gjitha donacionet, kontributet monetare dhe pagesat". Posa ka hyrë në fuqi UA-ja më 14 janar 2004, revizorët e OSBE-së kanë filluar trajnimin dhe organizimin e takimeve me personat për kontakte financiare të partive politike për t'i informuar për UA-në dhe implikimet për partitë politike.

1.2. Programi i revizionit

Në pajtim me standardet ndërkombëtare të llogaritjes, revizorët kanë përpiluar një program të revizionit të mjaftueshëm, në përputhje me këto standarde të aplikueshme të llogaritjes në Kosovë. Revizionet e kryera kanë pasur për qëllim të japin një vlerësim më të mirë të gjendjes financiare të partive politike duke i rishikuar shumat e publikuara të donacioneve dhe kontributeve monetare, të kontributeve në natyrë dhe të pagesave si dhe zbatimin e kërkesës për transparencë të partive politike.

1.3 Vlerësimi i rrezikut

Revizionet e mëparshme të viteve 2001 dhe 2002 kanë përfshirë vetëm fushatën e publikimeve financiare. Kësaj radhe ka qenë rasti i parë që të gjitha partitë politike të regjistruara dhe personat e tyre të kontakteve për çështje financiare të bëjnë një revizion që i përfshin të gjitha aktivitetet për vitet fiskale 2002 dhe 2003. Edhe pse partitë politike nuk kanë qenë të mësuar të përgatisin raporte financiare vjetore, kërkesat për publikime janë thjeshtësuar në mënyrë që të lehtësohet kuptimi dhe zbatimi i tyre. Vlerësimi i përgjithshëm i procesit vjetor të revizionit mund të

kuptohet si i kënaqshëm. Të gjitha partitë politike që kanë qenë subjekt i revizionit, tashmë kanë qenë të njohura me publikimin e transaksioneve të tyre financiare dhe me përvojë edhe më të madhe për mbajtjen e shënimeve të tyre dhe skedimin e dokumenteve ligjore siç janë dëftesat, llogaritë dhe faturat. Përveç kësaj, revizorët kanë pasur informata nga burime të ndryshme të hulumtuara gjatë vitit 2002 dhe gjithashtu deklaratat e partive politike mbi publikimin financiar të fushatës së tyre. Prandaj, rreziku i padëshiruar i revizionit, rreziku i kontrollit dhe rreziku i zbulimeve që mund të përmbajë, do të jenë me gjasë në nivel më të ulët në krahasim me revizionet e mëparshme.

1.4 Materialiteti

Materialiteti i referohet cilësisë së informatave që përmbajnë shënimet financiare me të cilat punon Zyra. Në rastet kur informatat janë harruar ose janë konsideruar të pasakta, revizorët i janë referuar secilit burim të vetëm që është përdorur gjatë revizioneve të mëparshme të publikimeve financiare - siç është fushata e publikimeve financiare për zgjedhjet komunale të vitit 2002, si dhe të gjitha llogaritë, faturat dhe dëftesat. Për vitin 2003, revizorët kryesisht u janë referuar shifrave të dorëzuara nga partitë politike.

1.5 Vërejtjet

- Zyra konsideron se revizioni duhet të përqendrohet në ato parti të cilat kanë fituar vende në zgjedhjet parlamentare të vitit 2001, meqë ato kanë të drejtë të kenë përkrahje financiare nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës (BKK) dhe Fondi i Përkrahjes së Demokratizimit. Kjo është me interes të madh për publikun, jo vetëm për hir të transparencës por edhe për shkak se këto parti kërkojnë të fitojnë përkrahje financiare nga xhepi i publikut. Pos kësaj, të gjitha partitë politike të regjistruara në Kosovë, pa marrë parasysh nëse kanë fituar vende apo jo, janë kontrolluar nga revizorët.
- Zyra ka qenë e mendimit që revizioni i partive politike duhet të përqendrohet në shumat të cilat kalojnë limitin e kërkuar për raportim dhe hapësira e mundshme për të gabuar është vlerësuar si e vogël. Revizioni i ka shënuar disa mospërputhje ku publikimi i shpenzimeve të fushatës në zgjedhjet e vitit 2002 nuk është shënuar në raportin financiar vjetor. Pasi që janë bërë kontakte, partitë i kanë korrigjuar informatat e tyre. Revizioni nuk ka hetuar ndonjë mospërputhje të rëndësishme që do të ndryshonte mendimin e revizorëve. Kjo nënkupton që mund të kenë mbetur jashë publikimit shuma mbi limitin për raportim, por edhe nëse është kështu, kjo nuk do të ketë ndonjë ndikim të rëndësishëm në shqyrtimin e përgjithshme të publikimeve.

3. VLERËSIM I PËRGJITHSHËM

Revizorët kanë filluar procesin e hetimeve dhe të verifikimeve në lidhje me publikimet financiare të partive politike, duke përcjellë afatin për dorëzimin e publikimeve financiare për vitet 2002 dhe 2003, në përputhje me UA-në. Rruga që është ndjekur gjatë procesit të hetimeve dhe verifikimeve është parashikuar të jetë brenda fushëveprimit të revizionit për të cilin revizorët janë dakorduar. Meqë zgjedhjet e ardhshme do të ngrejnjë interesimin dhe vëmendjen e drejtpërdrejtë ndaj aktiviteteve, kryerjes së punëve të partive politike dhe gjendjes financiare, publikimi i informatave financiare për vlerësim të publikut do të fitojë vëmendje të shtuar.

Në lidhje me UA-në nr. 2004/01, që ka hyrë në fuqi, Zyra ka organizuar sesionin e pyetjeve dhe të përgjigjeve për partitë politike më 22 janar 2004, në lidhje me zbatimin e UA-së. Në atë takim, revizori i lartë dhe asistenti i revizorit të lartë bënë prezentimin për UA-në dhe pastaj u

përgjigjen pyetjeve. Niveli i pjesëmarrjes së partive politike nuk ka qenë i lartë dhe vetëm kryetari i PNDSh-së dhe personat për kontaktim për çështje financiare të PGJK-së, LKÇK-së, LPK-së, PReK-ut, PLK-së, BKDSH-së dhe PD-së morën pjesë në sesion. Pjesëmarrësit janë informuar për kërkesat për raportim dhe për publikimin financiar të partive politike si dhe për çështje të tjera. Gjatë seancës, nga pjesëmarrësit u kërkuar të jenë më të kujdesëshëm kur të raportojnë e posaçërisht në lidhje me kontributet në natyrë (në mall dhe shërbime). Pas kësaj seance me pyetje dhe përgjigje, AAK-ja ka kontaktuar me Zyrën për të marrë informata në lidhje me UA-në e lartpërmendur. Personit të kontakteve për financa të AAK-së i është dhënë informacioni i domosdoshëm dhe i mjaftueshëm. Po ashtu edhe një numër i vogël i partive të tjera kanë marrë informata plotësuese përmes telefonit.

Përgjegjësitë e partive politike për raportet financiare vjetore për vitet 2002 dhe 2003 në formularin e përkthuar nga Zyra janë si vijon.

Nga partitë politike Zyra ka kërkuar të dorëzojnë informatat vijuese jo më vonë se më 1 maj 2004:

- emrin, shkurtësën, adresën, identitetin e personit për kontaktim për financa, numrin për kontaktim të partisë, numrin e regjistrimit të tatimit (nëse ekziston) dhe numrin e punëtorëve.
- çdo kontribut në të holla prej një burimi të veçantë gjatë vitit, nëse vlera e gjithmbarshme e të gjitha kontributeve prej atij burimi gjatë vitit kalon mbi 1,500 euro.
- çdo pagesë monetare gjatë vitit prej burimit të veçantë, nëse vlera e gjithmbarshme e të gjitha pagesave gjatë vitit kalon mbi 10,000 euro, duke identifikuar qëllimin e pagesës.

TË ARRITURAT

Kjo ishte hera e parë që partive politike u është kërkuar dorëzimi i raportit financiar vjetor. Pothuajse të gjitha partitë politike i kanë dorëzuar raportet e tyre me kohë dhe të përfunduara me drejtësi dhe korrektësi. Mendimi i Zyrës është që procesi i publikimit financiar për vitin 2002 dhe 2003 në raportet financiare vjetore ka treguar përmirësim të dukshëm të rezultateve të procesit të publikuar financiar në krahasim me vitet e kaluara.

Edhe pse partive politike u është kërkuar vetëm raportimi i donacioneve dhe kontributeve që kalojnë mbi 1,500 euro nga një burim i vetëm dhe pagesat mbi 10,000 euro një burim të vetëm brenda vitit, shumë prej tyre kanë publikuar shumën më të ulët se këto limite. Transparencë më e madhe është arritur duke iu mundësuar medieve dhe votuesve/publikut qasje në aktivitetet financiare të partive. Publiku tani ka qasje në listat e donatorëve të partive politike dhe të furnizuesve më të mëdhenj të partive politike me mallëra dhe shërbime.

Shumica e partive politike kanë treguar gatishmëri të vërtetë që të jenë më transparente në gjendjen e tyre financiare për të mirën e popullit. Në përgjithësi, ka pasur përmirësim të përgjithshëm të cilësisë dhe të raporteve të partive të vogla politike.

REKOMANDIMET PËR PËRMIRËSIME TË MËTEJSHME

Për këtë periudhë të raportimit është vënë re përmirësim i madh i bashkëpunimit ndërmjet partive politike dhe revizorëve. Veç tjerash, sa i përket procesit të revizionit, është vërejtur një shkallë e lartë e mirëkuptimit gjatë kryerjes së revizionit financiar. Këto revizione nuk janë bërë në interes të OSBE-së por për përmirësimin e transparencës financiare të partive politike dhe në interes të votuesve.

Revizorët do të punojnë në drejtim të një sistemi, në të cilin partitë politike do të detyrohen të paraqesin një fletë bilanci të përfunduar të të hyrave dhe paraqitjen e shpenzimeve në pajtueshmëri me standardet llogaritëse të pranura ndërkombëtarisht.

Për t'u ndihmuar partive politike, Zyra do të mbajë sesione trajnimi dhe po ashtu do të mund të sigurojë një softuer kompjuterik për llogaritje nëse paraqitet nevoja për këtë mendim.

Vështërsitë e hasura në këtë proces të skedimit ishin kryesisht të natyrës teknike. Shumica e partive politike kanë dorëzuar formularë të shkruar me dorë, të cilët nganjëherë ka qenë vështirë t'i lexojnë revizorët dhe ka pasur gabime të shumta gjatë shënimit në bazën e të dhënave. Për kompenzimin e këtyre, partive politike u është dhënë kopja e informatave të shënuara në bazën e të dhënave dhe u është kërkuar konfirmimi i saktë i informatave. Është me rëndësi që informatat në bazën e të dhënave të jenë të sakta meqë ato do të publikohen në faqën e internetit për qasje publike.

Informatat e marra nga formularët e dorëzuar në të shumtën e rasteve ishin të papërfunduar - mungonin emrat dhe/ose adresat e kontribuesit ose të pranuesit të pagesave. Në shumë raste ishte dhënë vetëm emri pa mbiemër ose adresë. Qëllimi i këtij ushtrimi nuk është të ekspozohet ndonjë individ, por të përkrahet transparenca.

Fakti se ka individë që kontribuojnë për partitë politike është gjë e mirë qoftë ajo ndihmë me të holla ose duke marrë pjesë në aktivitete politike, dhe është pjesë e procesit demokratik, prandaj duhet të inkurajohet.

Rekomandimet e përmbledhura për përmirësimin e këtij publikimi:

- Partitë politike duhet të jenë më të vetëdijshme për nevojën e sigurimit të informatave më të sakta.
- Zyra do t'i ndihmojë partitë politike që të pajisen me softuer i cili do t'i bënte më të lehta proceset e raportimit.
- Një sistem kompjuterik do të shmangte vështërsitë teknike siç janë gabimet e shkrimit etj.

4. BURIMET E INFORMIMIT

Burimi kryesor informativ ka qenë raporti financiar vjetor i dorëzuar nga partitë politike dhe revizorët janë mbështetur kryesisht në informatat e publikuara në këto raporte. Kur kishte mungesë informacioni, kërkoheshin informata shtesë nga personat për kontakte financiare të partive politike. Gjithashtu kemi bërë edhe krahasime me raportet financiare të mëparshme të dorëzuara nga partitë si dhe krahasimet e partisë me partitë e tjera. Veç kësaj, për vlerësim dhe qëllime krahasimi janë përdorur informatat të cilat ishin mbledhur gjatë periudhës së fushatës së zgjedhjeve komunale të vitit 2002 prej individëve, përkitazi me rrogat, çmimet e mallërave dhe shërbimet e bizneseve dhe të furnizuesve.

Duhet theksuar se, gjatë procesit të hetimit dhe verifikimit, partitë politike kanë bashkëpunuar me revizorët në mënyrë që Zyra të pajiset me informata shtesë sa u përket donacioneve monetare, kontributeve në natyrë dhe pagesave.

ANALIZA E PËRGJITHSHME E RAPORTEVE TË DORËZUARA

Njëzet e katër parti politike (AAK, BSDAK, DSB (DRSM), GIG, IRDK, KDTP, KOS, LDK, LKÇK, LPK, PD, PDASHK, PDK, PGJK, PLK, PNDSH, PREBK, PRK, PRSH, PSDK, PSHDK, SDA, UDGJ, UNIKOMB), prej të cilave 27 të regjistruara në Kosovë, kanë dorëzuar me kohë raportet financiare vjetore për vitet 2002 dhe 2003. Tri parti ishin gjobitur për

mospërputhje me Urdhëresën Administrative nr. 2004/01. Së bashku me gjobat, BK-së, BKDSH-së dhe PDAK-ut u është dhënë kohë shtesë për dorëzimin e raporteve financiare vjetore për vitet 2002 dhe 2003. PDAK-u ka dorëzuar raportet financiare vjetore për të dyja vitet pasi ishte gjobitur. BK-ja dhe BKDSH-ja janë dënuar për mosrespektim të rregullave për herë të dytë dhe janë informuar për situatën dhe nuk do të çertifikohen për zgjedhjet e ardhëshme në qoftë se nuk i dorëzojnë raportet financiare vjetore për vitet 2002 dhe 2003.

Një numër i partive nuk ka shënuar asnjë donacion monetar, kontribute në natyrë ose pagesë. Këto parti akoma do të mund të kishin transaksione financiare të kufizuara edhe pse nuk kanë publikuar asnjë nga të hyrat ose pagesat. Përderisa kontributet individuale të jenë nën 1,500 euro dhe pagesat vetëm një burimi nën 10,000 euro, kjo ende është në pajtim me UA-në. Disa nga partitë kanë vendosun vullnetarisht të publikojnë donacionet monetare dhe kontributet në natyrë të cilat nuk i kalojnë limitet për raportim. Ky informacion nuk do të përfshihet në këtë dokument dhe nuk do të publikohet në faqe të internetit.

Prej 25 partive politike që kanë dorëzuar raportet financiare vjetore, 13 prej tyre kanë qenë të pakënaqshme gjatë procesit të hetimit dhe verifikimit nga revizorët me mënyrën se si janë publikuar informatat në raportet financiare vjetore për vitet 2002 dhe 2003. Partitë politike që kanë pasur gabime me plotë kuptimin e fjalës dhe/ose pjesë të lëna jashtë publikimeve të tyre janë thirrur në mbledhje gjatë periudhës së hetimit dhe të verifikimit. Për këtë qëllim, janë mbajtur mbledhje me AAK-në, IRDK-në, LDK-në, PDK-në, PDASHK-un dhe PSDK-në që të shpjegohet dhe theksohet rëndësia e publikimit të informatave për të hyrat dhe pagesat që i kalojnë limitet e kërkuara për raportim dhe e respektimit të UA-së për të mirën e një shoqërie më demokratike.

Gjatë procesit të hetimit dhe verifikimit, revizorët kishin krijuar një bazë të të dhënave për regjistrimin e të gjitha informatave të dorëzura nga partitë politike në mënyrë që të kenë shënime sa më të sakta dhe me qasje për partitë. Do të shfrytëzohet edhe baza e të dhënave për publikimin e informatave përkitazi me donacionet dhe kontributet monetare, kontributet në natyrë dhe pagesat. Ky informacion do të vendoset në faqe të internetit.

Në përputhje me UA-në, neni 4.5, partitë politike të cilave u është bërë revizioni janë paraqitur me rezultatet paraprake të revizionit. Partive u janë dhënë pesë ditë pune për dorëzimin e çdo shpjegimi që ka të bëjë me informacionin që mungon, gabimet e dukshme ose lëshimet e identifikuar nga Zyra.

4.1 Donacionet dhe kontributet monetare

Neni 3.1 i UA-së i obligon të gjitha partitë politike që të publikojnë identitetin e të gjithë personave që i japin partisë donacione ose kontribute monetare që e kalojnë shumën prej 1,500 euro brenda një viti. Zyra ka mbledhur emrat e donatorëve dhe të kontribuesve të partive politike për përpilimin e një liste që tregon shumën e donacioneve dhe identitetin dhe adresën e burimit. Lista do të publikohet për rishqyrtim publik në përputhje me UA-në.

Duhet të theksohet se në të shumtën e rasteve, partitë politike që kanë publikuar donacionet dhe kontributet monetare që kalojnë limitin e kërkuar për raportim, nuk kanë regjistruar në raporte adresat e sakta të donatorëve, siç është kërkuar. Gjithashtu, revizorët kanë hasur në shumë raste të donacioneve dhe kontributeve monetare të paraportuara kur i kanë krahasuar me raportet e vitit 2002 dhe me publikimet financiare të fushatës së po atij viti. Këto donacione dhe kontribute në natyrë të paraportuara kanë tërhequr vëmendjen e personave për kontaktime financiare për t'i rishqyrtuar edhe një herë partitë politike relevante. Duke përcjellë kërkesën e bërë nga revizorët

në lidhje me informatat e paraportuara, gati të gjitha partitë politike kanë dalur me informata shtesë përkitazi me identitetin dhe të gjitha adresat e donatorëve.

Tabela 1 : Publikimi i donacioneve dhe i kontributeve monetare të partive politike që kërkohet për raportim mbi limitin prej 1,500 euro nga i njëjti burim gjatë vitit të njëjtë fiskal.*

Partia politike	Shuma e gjithmbarshme e publikuar mbi 1,500 euro e donacioneve dhe kontributeve monetare (në euro)	
	2002	2003
AAK	77,415.00	193,939.00
DSB	NZ	9,860.60
GIG	NZ	9,907.50
IRDK	17,000.00	33,998.71
KDTP	6,020.00	32,118.71
KOS	2,500.00	NZ
LDK	146,946.42	805.960
LPK	4,120.00	39,608.71
LKÇK	3,632.00	32,118.71
PD	2,345.00	32,118.71
PDAK	8,700.00	4,500.00
PDK	137,464.41	485,928.33
PLK	15,513.47	NZ
PRëK	19,950.00	24,000.00
PSDK	5,463.30	2,000.00
PSHDK	5,790.00	32,118.71
SDA	NZ	11,341.50
UDGJ	NZ	5,000.00

4.2 Kontributet në natyrë (në mall dhe shërbime)

Kontributet në natyrë janë përcaktuar si kontribute të çdo malli ose shërbimi të çdo vlere të siguruar pa asnjë pagesë për të. Partitë politike kanë qenë të obliguara të publikojnë kontributet në natyrë që kalojnë mbi 1,500 euro nga i njëjti burim gjatë vitit të njëjtë. Në ato raste kur partive politike u ka munguar informacioni për emrin ose adresën e kontribuesit ose përcaktimi i mallit ose shërbimit që është marrë si kontribut në natyrë, është marrë kontakt me njerëzit dhe janë kërkuar të dhëna plotësuese për artikujt që mungojnë.

* Partitë politike që nuk kanë publikuar asnjë shifër që kalon limitin e kërkuar për raportim nuk janë përfshirë në këtë tabelë.

Publikimi i kontributeve në natyrë dhënë partive politike mbi limitin që kërkohet për raportim prej 1,500 euro nga i njëjti burim gjatë të njëjtit vit¹.

Partia politike	Shuma e gjithmbarshme e publikuar mbi 1,500 euro e donacioneve dhe kontributeve monetare (në euro)	
	2002	2003
AAK	29,720.00	17,000.00
LPK	1,500.00	2,500.00
PDK	140,701.00	9,892.00
PReK	16,310.00	16,650.00

4.3 Pagesat

Partitë politike kanë qenë të obliguara për t'i publikuar pagesat që kalojnë mbi 10,000 euro një burimi të veçantë brenda vitit të njëjtë. Një shumicë e partive politike nuk kanë publikuar asnjë pagesë në raportet e tyre financiare vjetore për vitet 2002 dhe 2003. Nga ana tjetër, një pakicë të partive politike që kanë publikuar pagesat që kalojnë mbi 10,000 euro për një burim të vetëm gjatë njërit ose tjetrit vit, shpesh u ka munguar qoftë adresa e plotë ose personi që ka marrë pagesën ose identifikimi i qëllimit të shfrytëzimit të asaj pagese. Në përputhje me UA-në përkatëse, revizorët kanë marrë kontakt me personat për kontaktime financiare të atyre partive politike lidhur me ato pagesa dhe kanë kërkuar më shumë informacion përkitazi me të dhënat që mungojnë.

Publikimi i pagesave të subjekteve politike mbi limitin e kërkuar për raportim prej 10,000 euro brenda të njëjti vit fiskal².

Partia politike	Shuma e gjithmbarshme e publikuar mbi 10,000 euro për pagesa (në euro)	
	2002	2003
AAK	17,290.00	102,824.00
IRDK	NZ	10,950.00
LDK	161.442	654.774,16
LPK	NZ	13,322.97
PD	NZ	11,300.00
PDK	166,610.00	419,528.49
PSHDK	NZ	21,978.08

¹ Partitë politike që nuk kanë publikuar asnjë shumë që kalon limitin e kërkuar për raportim për kontribute në natyrë nuk janë përfshirë në këtë tabelë.

² Partitë politike që nuk kanë publikuar asnjë shumë që kalon limitin e kërkuar për raportim për pagesa nuk janë përfshirë në këtë tabelë.

ANALIZË SIPAS PARTIVE POLITIKE

5.1. AAK – Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës

FORMULARËT DHE DOKUMENTET E DORËZUARA

AAK-ja i ka dorëzuar me kohë raportet financiare vjetore për vitet 2002 dhe 2003. AAK-ja gjithashtu i ka dorëzuar raportet financiare vjetore për të gjitha degët ndaras edhe partitë nuk kanë qenë të obliguara të dorëzojnë raporte të veçanta për secilën degë. Revizorët i kanë pranuar 24 raporte për secilin nga këto 2 vite dhe raportet janë pranuar si të dorëzuar. Edhe pse partitë politike nuk kanë qenë të obliguara të publikojnë informatat për kontributet nën 1,500 euro ose pagesat nën 10,000 euro, siç specifikohet me Urdhëresën Administrative (UA) nr. 2004/01, AAK-ja vullnetarisht i ka publikuar shumat që kanë qenë nën limitin e kërkuar për raportim.

TË HYRAT

AAK-ja ka publikuar gjithsej të hyra prej 121,306 euro për vitin 2002, nga të cilat 88,466 euro vijnë nga donacionet dhe kontributet monetare dhe 32,840 vijnë nga kontributet në natyrë (në mall dhe shërbime). Pos kësaj, të hyrat e publikuara për 2003 kanë qenë gjithsej 225,643 euro, nga të cilat 205,063 euro vijnë nga donacionet dhe kontributet monetare dhe 20,580 euro nga kontributet në natyrë.

a. Donacionet dhe kontributet monetare

AAK-ja ka publikuar informatën për 58 individë apo ndërmarrje që kanë dhënë donacione dhe kontribute monetare për vitin 2002 dhe 38 për vitin 2003. Kanë qenë në mes 58.20 dhe 38.12 mbi limitin e kërkuar për raportim prej 1,500 euro sipas Urdhëresës Administrative nr 2004/01. Shuma e donacioneve dhe kontributeve monetare që kalojnë nivelin e kërkuar ka qenë gjithsej 77,415 euro për vitin 2002, kurse 193,939 euro për vitin 2003. (shtojca 8)

b. Kontributet në natyrë

AAK-ja gjithashtu ka publikuar informatën për 12, përkatësisht, 10 individë ose ndërmarrje që kanë dhënë kontribute në natyrë për vitet 2002, përkatësisht 2003. Në grupin prej 12 individëve, kanë qenë 7 dhe në grupin prej 10 individëve - kanë qenë 4 sish mbi limitin e kërkuar për raportim prej 1,500 euro sipas të njëjtës Urdhëresë Administrative. Shuma e kontributeve në natyrë që kalon nivelin e kërkuar të raportimit për vitin 2002 ka qenë gjithsej 29,720 euro, derisa 17,000 euro kanë qenë për vitin 2003. (shtojca 9)

BAGESAT

Numri i pagesave të publikuara për vitet 2002 dhe 2003 ka qenë 33, përkatësisht 42. Në mesin e shifrave të publikuara për secilin prej 2 viteve, vetëm 1 nga 33 pagesat dhe 3 nga 42 pagesat kanë kaluar limitin e kërkuar të raportimit prej 10,000 euro, sipas Urdhëresës Administrative nr: 2004/01. Shuma e pagesave mbi nivelin e kërkuar të raportimit për vitin 2002 ka qenë 17,920

euro. Në anën tjetër, shuma e gjithmbarshme e pagesave që kalon nivelin e kërkuar të raportimit ka qenë 102,824 euro.

5.2. BSDAK – Partia e Akcionit Demokratik të Boshnjakëve të Kosovës

BSDAK-u i ka dorëzuar me kohë raportet financiare vjetore për vitet 2002 dhe 2003. BSDAK-u i ka shënuar 3 kontribute monetare për këto 2 vjet - 2002 dhe 2003; të gjitha kontributet kanë qenë nën limitin e raportimit prej 1,500 euro, sipas Urdhëresës Administrative nr: 2004/01. Partia nuk ka publikuar asnjë pagesë që kalon limitin e kërkuar të raportimit për asnjërin nga këto 2 vite.

5.3. DSB – Partia Boshnjake e Kosovës

DSB-ja i ka dorëzuar me kohë raportet financiare vjetore për vitet 2002 dhe 2003. Partia ka qenë e obliguar që të publikojë vetëm kontributet që kalojnë 1,500 euro ose pagesat që kalojnë 10,000 euro, brenda një viti prej një burimi të vetëm, sipas Urdhëresës Administrative nr: 2004/01. DSB-ja i ka shënuar 19 kontribute monetare me shumë prej gjithsej 425 euro, për vitin 2002; të gjitha kanë qenë nën limitin e kërkuar të raportimit. Për vitin 2003 partia ka publikuar të hollat e pranuar nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës prej gjithsej 9,860.60 euro.

DSB-ja nuk ka publikuar asnjë kontribut në natyrë (në mall dhe shërbime) as për vitin 2002 e as për vitin 2003. Për vitin 2002 partia ka publikuar 5 pagesa prej gjithsej 771 euro. DSB-ja ka publikuar 10 pagesa prej gjithsej 9,860.60 për vitin 2003. Të gjitha pagesat kanë qenë nën limitin e kërkuar për raportim prej 10,000 euro. Partia në mënyrë të kënaqshme ka dhënë informata të plota të kontribuesve dhe pranuesve të pagesave.

5.4. GIG – Iniciativa Qytetare e Gorës

GIG-u i ka dorëzuar me kohë raportet financiare vjetore për vitet 2002 dhe 2003. Partia ka qenë e obliguar të publikojë vetëm kontributet që kalojnë 1,500 euro ose pagesat që kalojnë 10,000 euro, nga një burim i vetëm brenda vitit, sipas Urdhëresës Administrative nr: 2004/01. GIG-u ka shënuar 33 kontribute monetare me gjithsej 562 euro për vitin 2002; të gjitha kanë qenë nën limitin e kërkuar për raportim. Për vitin 2003 partia ka publikuar të hollat e pranuar nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës prej gjithsej 9,907.50 euro.

GIG-u nuk ka publikuar asnjë kontribut në natyrë (në mall dhe shërbime) as për vitin 2002 e as për vitin 2003. Për vitin 2002 partia ka publikuar 9 pagesa prej gjithsej 562 euro dhe 7 pagesa për vitin 2003 prej gjithsej 9,907.50. Të gjitha pagesat kanë qenë nën limitin e kërkuar për raportim. Partia në mënyrë të kënaqshme ka dhënë informata të plota të kontribuesve dhe pranuesve të pagesave.

5.5. IRDK – Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës

IRDK-ja i ka dorëzuar me kohë raportet financiare vjetore për vitet 2002 dhe 2003. Partia ka qenë e obliguar të publikojë vetëm kontributet që kalojnë 1,500 euro ose pagesat që kalojnë 10,000 euro, nga një burim i vetëm brenda vitit, sipas Urdhëresës Administrative nr: 2004/01. IRDK-ja i ka shënuar 6 kontribute monetare prej gjithsej 17,000 euro, për vitin 2002. Për vitin 2003 partia ka publikuar të hollat e pranuar nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës prej gjithsej 32,118.71 euro dhe një donacion individual prej 1,880 euro.

Partia nuk ka publikuar asnjë kontribut në natyrë (në mall dhe shërbime) as për vitin 2002 e as për vitin 2003. Për vitin 2002 partia nuk ka publikuar asnjë pagesë, kurse për vitin 2003 partia ka publikuar vetëm 1 pagesë prej gjithsej 10,950 euro.

5.6. KDTP – Partia Demokratike Turke e Kosovës

KDTP-ja i ka dorëzuar me kohë raportet financiare vjetore për vitet 2002 dhe 2003. Partia ka qenë e obliguar të publikojë vetëm kontributet që kalojnë 1,500 euro ose pagesat që kalojnë 10,000 euro, nga një burim i vetëm brenda vitit, sipas Urdhëresës Administrative nr: 2004/01. KDTP-ja i ka shënuar 3 kontribute monetare prej gjithsej 8,170 euro, për vitin 2002, 2 prej të cilave kanë qenë nën limitin e kërkuar për raportim prej 1,500 euro. Për vitin 2003 partia ka publikuar të hollat e pranuar nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës prej gjithsej 32,118.71 euro dhe 2 donacione të tjera prej gjithsej 1,391 euro.

Partia ka publikuar 1 kontribut në natyrë (në mall dhe shërbime) për vitin 2002 prej 670 euro dhe asnjë kontribut për vitin 2003. Për vitin 2002, KDTP-ja ka publikuar 13 pagesa prej gjithsej 9,448.80 euro dhe 33 pagesa prej gjithsej 32,118.71 euro për vitin 2003. Të gjitha pagesat e publikuara kanë qenë nën limitin e kërkuar për raportim prej 10,000 euro.

5.7. KOS – Partia Objektive e Kosovës

KOS-i i ka dorëzuar me kohë raportet financiare vjetore që u përkasin viteve 2002 dhe 2003. Në raportet financiare vjetore të veta, KOS-i nuk ka publikuar asnjë shumë të donacioneve dhe të kontributeve monetare, as të kontributeve në natyrë (në mall dhe shërbime), as të pagesave që kalojnë limitet e kërkuara për raportim të parashikuara me Urdhëresën Administrative nr. 2004/01. Gjatë periudhës së hetimeve dhe të verifikimeve, deklaratat e partisë janë verifikuar duke i krahasuar me publikimet financiare të fushatës së partisë për zgjedhjet komunale të vitit 2002, dhe nuk është gjetur asnjë gabim apo mospërputhje.

Duke marrë parasysh përmasën e partisë dhe duke u bazuar në informatat e marra për kryerjen e punëve të mëparshme të saj, publikimi i saj është pranuar dhe nuk është zbatuar asnjë proces i mëtejshëm i hetimeve.

5.8. LDK – Lidhja Demokratike e Kosovës

FORMULARËT DHE DOKUMENTET E DORËZUARA

LDK-ja i ka dorëzuar me kohë raportet financiare vjetore për vitet 2002 dhe 2003. Pasi partitë politike nuk kanë qenë të obliguara që të publikojnë të dhënat për kontributet nën 1,500 euro ose pagesat nën 10,000 euro, siç parashikohet me Urdhëresën Administrative nr. 2004/01, LDK-ja ka raportuar vetëm për shumën mbi limitin e kërkuar të raportimit, gjë që është e kënaqshme.

TË HYRAT

LDK-ja ka publikuar të hyrat me gjithsej 146,946.42 euro për vitin 2002. Për vitin 2003, kjo parti ka raportuar për gjithsej 805,960 euro, nga të cilat 799,260 euro vijnë nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës dhe 6,700 euro nga degët e partisë.

a. Donacionet dhe kontributet monetare

LDK-ja ka publikuar informatat për 22 individë, ndërmarrje dhe degë të partisë që kanë dhënë donacione dhe kontribute monetare prej gjithsej 146,946.42 euro për vitin 2002. Partia ka publikuar dy donacione dhe kontribute monetare prej gjithsej 805,960 euro për vitin 2003, nga të cilat 799,260 euro vijnë nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës dhe 6,700 euro nga degët e partisë. LDK-së i mungon në raportin vjetor financiar për vitin 2002 adresa e një donatori i cili quhet Ethem Kupina.

b. Kontributet në natyrë (në mall dhe shërbime)

Partia nuk ka raportuar për asnjë kontribut në natyrë për vitet 2002 dhe 2003.

c. PAGESAT

Për vitin 2002 LDK-ja ka raportuar për një pagesë prej 161,442 euro për pagat e punonjësve të partisë. Për vitin 2003 partia ka raportuar për 16 pagesa prej gjithsej 654,774.16 euro, nga të cilat 226,510.91 euro kanë qenë për pagat e punonjësve të partisë.

5.9. LKÇK – Lëvizja Kombëtare për Çlirimin e Kosovës

